



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 10373/prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1593 datë 16.11.2012.

**SHOQËRISË “MU - LEU” SH.P.K
Lagjia 13, Rr. “Pavarësia”, Pista e Vogël “Iliria”, Durrës.**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Mu - Leu” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1593, datë 13.11.2012, për mineral ranor silicor, në objektin “Fshati Komarak”, Ballaban, Përmet.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.6588 prot., datë 25.07.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.10373 prot., datë 27.07.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1593, datë 16.11.2012, për mineral ranor silicor, në objektin “Fshati Komarak”, Ballaban, Përmet, për arsye se nuk është paguar nga shoqëria juaj, vlera e garancisë së rehabilitimit të mjedisit për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, siç është përcaktuar në pikën nr.1, neni 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germen “ç”, të pikës 1, neni 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1593, datë 16.11.2012, për mineral ranor silicor, në objektin “Fshati Komarak”, Ballaban, Përmet, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1593, datë 16.11.2012, për mineral ranor silicor, në objektin “Fshati Komarak”, Ballaban, Përmet.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit, në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENIS ALIKO

